



# LGBT e-NEWS

Numri 4, Viti II i Botimit, Maj-Qeshor 2011, TIRANË  
Financuar nga: Programi MATRA, Ministria e Punëve të Jashtme e Hollandës  
Botim i LGBT PRO Shqipëri në partneritet me COC Hollandë

Për komente, sugjerime apo pyetje na kontaktoni në [info@pinkembassy.al](mailto:info@pinkembassy.al). Për më shumë vizitoni [www.pinkembassy.al](http://www.pinkembassy.al)

## Shqipëria marshon në Athens Pride

**PINK Embassy/LGBT PRO Albania**, një grup që punon për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT, u bë organizata e parë shqiptare që dërgoi një delegacion prej 25 anëtarësh dhe mbështetësish në Pride-in e zhvilluar në Athinë në Maj 2011. Ambasada PINK ka mbështetjen e COC Hollandë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Hollandës.

Shqipëria u bë kështu ndër vendet e fundit në Europë që i'u bashkua levizjes europiane të LGBT-ve. Individë të komunitetit LGBT në Shqipëri jetojnë me frikën e përjashtimit e të dhunës, ndaj e kanë të veshtirë të tregojnë hapur orientimin e tyre seksual.

PINK Embassy/LGBT PRO Albania dëshiron që çdo lesbike, gay, biseksual dhe transgjinnor të jetë krenar për atë që është. Ne përpiqemi të përmirësojmë qëndrimin dhe reagimin e qeverisë shqiptare dhe gjithë shoqërisë ndaj personave dhe çështjeve LGBT. Synimi kryesor mbetet integrimi i LGBT-ve në të gjitha aspektet e jetës në Shqipëri.

Lëvizja shqiptare LGBT është bërë e njohur jo vetëm në vend, por edhe në rajon që në vitin e parë të krijimit. Kjo është



bërë e mundur falë miqve dhe bashkëpunëtorëve tanë në Shqipëri dhe Europë, nga misionet diplomatike deri te organizatat e mbrojtjes të së drejtave të njeriut.

Shumë shqiptarë të komunitetit LGBT jetojnë e punojnë në Greqi, por një numër fare i vogël ka arritur t'ia pranojë këtë përkatësi familjarëve apo miqve. Marshimi në Pride është edhe për ata që nuk kanë mundësi të shfaqen. Zëri ynë do t'i bashkohet Athens Pride 2011 me shpresën që së shpejti të organizojmë të parin "Tira-na Pride" në kryeqytetin

shqiptar.

Athens Pride 2011 do të jetë një udhërrëfyes për të gjithë ne. Përfitojmë nga rasti t'i bëjmë thirrje shoqërisë shqiptare të respektojë të drejtat e komunitetit LGBT!

Sot bashkojmë zërat tanë me Athens Pride nën sloganin: **KISS ME EVERYWHERE!-PUTHMË KUDO!**

## INTERVISTË AMBASADOR PINK

# Belioza Çoku

Athens Pride; Një nga eksperiencat më të bukura të këtyre viteve.

### **PINK - A e kishit menduar më parë se do të marshonit dhe ju në një Pride?**

**Belioza Çoku** - Po të me pyesnit para dy vjetesh, me siguri pergjigjia do te ishte jo, pasi edhe vetë nuk i njihja në detaje organizime të kësaj natyre. Por që kur kam nisur te punoj pranë komunitetit LGBT në Shqipëri, në Ambasadën PINK, sigurisht që e kam menduar, dhe shumë madje. Prej më shumë se 12 vjet, punoj në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe në një farë mënyre më duket sikur edhe angazhimi aktiv pranë Ambasadës PINK, është thjesht vazhdim i asaj që kam bërë me shumë dëshirë gjithmonë; mbrojtja e të drejtave të njeriut. Gjeja e re, që ndjej në këtë eksperiencë, është energjia e pashtershme e djemve dhe vajzave që angazhohen apo punojnë pranë Ambasadës Pink, më ka përcjellë akoma dhe më shumë energji, për t'u përfshirë edhe në aktivitete apo organizime si Pride.

### **Sa e rëndësishme është, sipas jush, mbështetja në të tilla evente nga persona heteroseksualë?**

Është gjithmonë e rëndësishme, pasi çdonjëri prej nesh kërkon mbështetje si në jetën e përditshme ashtu dhe

në evente te veçanta. Në Athens Pride, e ndjeje nga afër këtë, pasi shikoje shumë çifte heteroseksuale, të moshave të ndryshme, që së bashku me fëmijët e tyre, vinin dhe vizitonin stendat e organizatave LGBT, duke bashkëbiseduar duke shkëmbyer informacione, apo duke dhuruar diçka. Të drejtat e njeriut, janë thelbësore dhe njësoj te rëndësishme për këdo, pavarisisht orientimit seksual.

### **Mund të na përshkruani emocionet që ndiheshin aty?**

Jam shume e lumtur që nuk e humba mundësinë për të marrë pjese në këtë aktivitet madheshtor. Ishte fantastike të ishe atje. Emocionet që përjetova ishin me aq shumë ngjyra të bukura, ku reflektoheshin si ngjyrat e flamurit LGBT, ashtu dhe ato të flamurit Shqiptar. Një grup profesionistësh nga vende të ndryshme të botes, drejtonin marshimin e me shumë se 8000 vetave, duke i rënë disa daulleve karakteristike. Sensi ritmik i tyre, e përshkonte tej për tej turmen e njerezve që i bashkoheshin gjatë gjithë kohës së marshimit. Flamuri simbol i komunitetit LGBT vlevitej nga të gjithë me rradhë dhe performancat muzikore apo kërcimet nga përfaqesues të komunitetit LGBT nuk munguan. Kam shijuar çdo moment të atij eventit



dhe ishte shumë bukur të shikoje aq shume pjesmarrës pa dallim race, kombi, feje, gjinie, apo orientimi seksual, që marshonin paqësisht për një kauzë të drejtë. Ia vlejti dhe e vleresoje si një nga eksperiencat më të bukura të këtyre viteve të fundit. Ishte fantastike.

### **Sa larg e shihni organizimin e një Tirana Pride?**

Siç e thashë më lart, unë vazhdoj të jem nën efektin e energjise që percillet çdo ditë e më shumë tek Ambada Pink dhe çdo ditë e më shumë takoj, të rinj, të reja, heteroseksuale apo homoseksuale, që besojnë në veten e tyre. Takoj dhe prinder mëndjehapur dhe mikpritës ndaj informacionit mbi të drejtat e njeriut dhe jetën e komunitetit LGBT në Shqipëri. Jam optimiste edhe për një pjesë të mirë të shqiptarëve që i respektojnë të drejtat e njeriut dhe besoj fort që edhe ketu mund të organizojmë në një të ardhme jo të largët një Pride, që mund vlejë dhe pse jo të lërë jo me pak mbresa se Pride-t që organizohen prej vitesh ne vendet e zhvilluara.



# EKSPERIENCA E PARË NË PRIDE

*Emocionet e një pjestari të komunitetit LGBT në këtë event...*

**A e kishit menduar ndonjë herë se do te merrnit pjesë në Pride?**

Të them të vërtetën po, por mendoja se ky ishte një event i cili do të ndodhte shumë vonë në jetën time. Ishte një eksperiencë që nuk do doja ta kisha humbur për as një gjë në botë. Pres ta përjetoj përsëri. (Buzëqesh)

**Cili ka qënë reagimi juaj i parë kur morët vesh se Ambasada Pink do të dërgonte një delegacion në Pride?**

U emocionova. E prisja me padurim dhe të them të drejten mu duk vetja si një fëmijë i cili me padurim

priste një dhuratë shumë të madhe, dhe e tillë ishte.

**Cila ishte ndjesia e marshimit me mijëra vetë të tjerë që luftojnë për të njëjtën çështje si ju?**

Ishte një ndjenjë argetimi, miqësie por mbi të gjitha lirie. Ishte hera e parë në jetën time në të cilën bëja një gjë që dashuroja në mënyrë 100% të lirë. Më bëri të ndihem 100% unë. Kam kërcyer, kam kënduar, kam qeshur, kalova kohën me miq të dashur për mua dhe këtë gjë jo të gjithë e përjetojnë prandaj falenderoj Zotin për këtë gjë (Qesh).

**Do ta bëni përsëri po t'ju jepej mundësia?**

Pa diskutim.

**Pas sa kohësh mendoni se mund të organizohet një Pride në Tiranë?**

Shumë afër nuk e shoh por as shumë larg. Mendoj se ngadalë të gjithëve do t'u duhet një eksperiencë e tillë dhe mbi të gjitha është një manifestim i dashurisë njerëzore dhe nuk ka arsye pse diçka e tillë të mos bëhet dhe në Tiranë. Shpresoj që njerëzit ta kuptojnë sa më shpejtë këtë gjë.



## Konferenca për Solidaritetin dhe Bashkëpunimin në Greqi Ambasada PINK përfaqëson Shqipërinë

Më 26 Maj, përfaqësues të Ambasada PINK morën pjesë në mbledhjen e dytë të Konferencës së Solidaritetit dhe Bashkëpunimit në Greqi. Të pranishme në këtë konferencë ishin organizata nga vende të ndryshme të Mesdheut. Një falenderim i veçantë, për pjesëmarrjen tonë në këtë konferencë i shkon Znj. Konstantina Kosmidou, e cila këmbënguli për pjesëmarrjen e Shqipërisë në të.

Konferenca ishte shumë e dobishme për shumë arsye. Së pari, krijoi mundësinë e krijimit të kontakteve me organizata të shteteve të ndryshme mesdhetare. Së dyti, në bisedat dhe takimet me përfaqësuesit e organizatave nga Greqia, Turqia, Qipro, Qipro e Veriut etj, grupi i Ambasadës PINK kuptoi se problematikat tona ishin shumë të ngjashme me ato të vendeve të tjera, me ndryshimin e vetëm se tek ne ka ende shumë punë për t'u bërë. Ndërkohë që në Shqipëri ne duhet të merremi me shumë problematika njëkohësisht, organizatat e tjera kishin mundësi të fokusoheshin në çështje më të specifikuar.

Ditën e parë të konferencës u bë një prezantim për konferencën e parë e cila u organizua në Qipro vend ku çështjet mbi të drejtat e LGBT-ve janë ende shumë problematike. Më pas u zhvilluan dy workshop-e paralele, i pari; Të drejtat e LGBT janë të Drejtat e Njeriut, dhe i dyti; Roli i shoqërisë civile në mbështetje të të drejtave të LGBT-ve në Mesdhe. Më pas u zhvilluan disa ëorkshop-e për fjalimet e urrjetjes dhe krimet e urrjetjes, roli i institucioneve europiane për zhvillimin e barazisë së LGBT-ve në vendet mesdhetare dhe advokimi për barazi të transgjinnorëve në mesdhe etj.

Ditën e dytë të konferencës të gjithëve ju dha mundësia për të bërë një prezantim të shkurtër të organizatave përfaqësuese dhe më pas u vendos se cilat ishin pikat më të dobta në aftësitë e tyre për advokatësi. Pas një debate të gjatë, u zhvillua një tjetër për të vendosur se në



cilin vend do të mbahej konferenca e radhës. U propozua që për vitin e ardhshëm vendi organizativ të jetë Turqia, dhe vitin pasues vendi pritës të jetë Shqipëria.

Pas mbylljes zyrtare të konferencës u mbajt një takim i hapur me pjesëtarë të komunitetit ku u ndanë histori *coming out*. Ky ishte një takim prekës, për të cilin mund t'ju tregojmë në një nga numrat e ardhshëm të Newsletter-it tonë.

Ambasada PINK falenderon të gjithë aktivistët që morrën pjesë në konferencë, dhe i mirëpret në aktivitete të tjera.